



**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS**


**NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH
OF KOSOVA**



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË,
SEZONA 2024/2025 (JAVA 14-TË)**

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,
2020/2021 - 2024/2025**

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2024/2025 karakterizohet me numër më të lartë të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njejtë të sezonës 2023/2024 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të, 2024/2025 (Graf. 1).

Grafikoni.1



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2024/2025 DHE PRAGU EPIDEMIK


Nga fillimi i sezonës, 30 shtator 2024 deri më 06 prill 2025 (java e 14-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 100,626 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 10,074 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 131 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 14-të (31.03.2025-06.04.2025) janë raportuar 1,366 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 77 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 1 rast SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar: 72 raste ILI, 3 raste ARI dhe 1 rast SARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 14-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasur me javën e kaluar shënon një rënie prej 41.7%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Gjilanit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Prishtinës dhe Kamenicës. (Graf.3).


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç (Graph.4). Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (4,286 raste) pastaj grup-mosha 15-64 vjeç (3,204 raste), 5-14 vjeç (1,552 raste) dhe grup-mosha 65+ vjeç (1,032 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2024/2025 deri me 09 prill 2025, janë testuar gjithsej 5,096 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 2,541 (49.86%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 2,555 (50.13%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 17 raste (0.66%). Nga 2,555 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 785 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 31.72 %). Sipas tipit: me Influcencë A (376 raste apo 14.71%) dhe Influcencë B (409 raste apo 16%). Nga 785 rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B, sipas komunave: Mitrovicë (241 raste), Prishtinë (233 raste), Fushë Kosovë (47 raste), Podujevë (26 raste), Vushtrri (26 raste), Lipjan (25 raste), Drenas (24 raste), Malishevë (22 raste), Pejë (21 raste), Ferizaj (20 raste), Obiliq (16 raste), Skenderaj (15 raste), Suharekë (11 raste), Prizren (10 raste), Gjilan (9 raste), Gjakovë (6 raste), Shtime (6 raste), Rahovec (6 raste), Klinë (6 raste), Viti (5 raste), Hani i Elezit (3 raste), Istog (2 raste), Dragashi (2 raste) dhe me nga një rast komuna e Graçanicës, Novobërdës dhe Deçanit, kurse sipas grup-moshës: 0-4 vjeç (304 raste), 5-14 vjeç (220 raste), 15-29 vjeç (96 raste), 30-44 vjeç (56 raste), 45-60 vjeç (58 raste) dhe 60+ (51 raste). Gjatë javës së katërbëdhjetë (31.03.2025-06.04.2025), në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK janë testuar 51 mostra si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra janë konfirmuar dy raste pozitive. Kurse nga labororet private janë raportuar gjithsej 68 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Rastet pozitive i takojnë komunave: Prishtinë dhe Ferizaj, dhe grup-moshave 0-9 dhe 50-59. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 194 mostra me RSV, 190 mostra me Human Rhinovirus, 110 mostra me Human Adenovirus, 44 mostra Metapneumovirus dhe 10 mostra me Parainfluenza Virus.


Nga 194 rastet pozitive në RSV (7.59%): 169 (87.11%) prej tyre i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç, 13 raste i takojnë grup-moshës 5-14 vjeç, 15-34 vjeç (4 raste), 35-50 vjeç (1 rast), 51-64 vjeç (2 raste) dhe 65+ vjeç (5 raste), kurse sipas komunave: Prishtinë (75 raste), Fushë Kosovë (17 raste), Podujevë (16 raste), Vushtrri (11 raste), Drenas (10 raste), Ferizaj (7 raste), Malishevë (6 raste), Obiliq (5 raste), Lipjan (5 raste), Mitrovicë (5 raste), Skenderaj (5 raste), Gjilan (4 raste), Shtime (4 raste), Klinë (4 raste), Kaçanik (4 raste), Pejë (4 raste), Suharekë (3 raste), Prizren (3 raste), Gjakovë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Rahovec, Deçan, Viti dhe Kamenicë.

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me Influcencë A të pasubtipizuar janë 341 raste (43%), me subtipin AH3 janë 30 raste (4%), me subtipin AH1N1 janë 5 raste (1%), Influcencë B të pasubtipizur janë 400 raste (51%) dhe Influcencë B Victoria 9 raste (1 %).

Grafikoni.6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor dhe sanitar të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2024/2025, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe huthja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori 2024 deri me 27 mars 2025 janë administruar 66,875 doza. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 44,804 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 20,555 me sëmundje kronike, 1,478 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatëzëna dhe 35 fëmijë (0-5 vjeç).

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 43 raste me ARI, 1 rast me ILI dhe 1 rast me SARI.

Nga Klinika Infektive përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse deri më 9 prill 2025, janë raportuar 5 raste të vdekjes me Influcencë A dhe 1 rast i vdekjes nga COVID-19. Të gjitha rastet janë të gjinisë mashkullore, i përkasin grup-moshës mbi 60 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË**INFLUENCA SEZONALE JAVA 14/2025 NË EVROPË**

Aktiviteti i viruseve respirator vazhdon të mbetet i lartë në BE dhe ZEE. Aktiviteti i gripit ka arritur kulmin në javën e 6-të të vitit 2025, me numër më të ulët të rasteve të raportuara në pothuajse të gjitha vendet. Vazhdon të dominojë varianti i viruseve të gripit A dhe B. Aktiviteti i RSV-së (Virusit Respirator Sincial) mbetet i lartë. Ndikimi më i madh në kujdesin dytësor është vënë re tek të rriturit mbi 45 vjeç për gripin sezonal (duke dominuar mosha e shtyer) dhe tek fëmijët nën pesë vjeç për RSV. Mortaliteti i tepërt është vënë re që nga java e 51-të e vitit 2024, duke prekur të rriturit mbi 45 vjeç, me nivelet që tani janë rikthyer në gamën e pritshme. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie të qëndrueshme që nga vera e vitit 2024, pa u vërejtur asnjë epidemi dimërore deri tani, dhe mbetet në nivele të ulëta.

Burimi: <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/communicable-disease-threats-report-week-14-2025.pdf>